

PROCESVERBAL
nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 15.05.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencës: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nuk ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (pushim vjetor).

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef kabineti mr. Dragica Ljubevska, zëvendësoi Drejtorin e Agjencisë në pëputhje me Autorizimin, ark. nr. 03-1112/1 datë 19.03.2025.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë: mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 14:30 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Shënim: Z.Ajdini, për arsye teknike, në seancë përmes lidhjes video-konferencë kishte qasje vetëm me lidhje audio, pa mundësi për video transmetim.

Z. Trajçev vazhdoi diskutimin nga seanca e mëparshme në lidhje me Rendin e ditës dhe propozoi të vendoset pika "Të ndryshme". Arsyeja e dhënë ishte se disa anëtarë të Këshillit mund të kenë nevojë të deklarohen ose të ngrenë çështje për temë të caktuar, pa qenë paraprakisht e propozuar zyrtarisht si pikë e veçantë e rendit të ditës. Ai theksoi se pika "Të ndryshme" ishte praktikë e rregullt dhe e zakonshme në punën e Këshillit në vitet e fundit, dhe kështu është dhe në shumë institucione të tjera. Me vendosjen e kësaj pike do të mundësohet një shkallë më e lartë fleksibiliteti dhe lirie në punën e anëtarëve të Këshillit, me anë të së cilës secili anëtar, në çdo seancë, do të kishte mundësinë të deklaronte mendimin e tij, propozim ose koment mbi një situatë të caktuar, pa pasur paraprakisht detyrim për formulim si pikë e Rendit të ditës. Z. Trajçev theksoi se roli i anëtarëve të Këshillit nuk konsiston vetëm në shqyrtimin e pikave të përgatitura paraprakisht nga shërbimet dhe Kryetari i Këshillit, por

nënkupton edhe përfshirje aktive përmes pikëpamjeve dhe iniciativave personale gjatë vetë seancave.

Z. Petrushevski theksoi se ai vetë kishte propozuar që çdo anëtar i Këshillit të ketë të drejtë në fillim të seancës të propozojë një pikë të re në rend të ditës. Në prezantimin e tij, ai trajtoi tre aspekte relevante të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe Rregulloren e Punës së Agjencisë. Së pari, ai iu referua nenit 13, paragrafi (1) të LSHMAAV, ku është konstatuar se seancat e Këshillit thirren nga Kryetari i Këshillit. Plotësuese, sipas paragrafit (7) nga Ligji i njëjtë, materialet për seancat përgatiten nga Shërbimi Profesional i Agjencisë. Në këtë kontekst, theksoi se nëse ndonjë pikë që propozohet në seancë kërkon punë përgatitore nga shërbimi, është problematike nëse nuk njoftohen paraprakisht, sepse shërbimi nuk do të ketë mundësi ta përgatisë në mënyrë adekuate. Për shembull, diskutim në kuadër të pikës "Të ndryshme" rreth pjesëmarrjes së anëtarëve në seanca që nga formimi i Këshillit deri më sot. Për një diskutim të tillë, është e nevojshme që shërbimi paraprakisht të përgatisë një listë të të dhënave për pjesëmarrje, gjë që nuk do të ishte e mundur pa njoftim në kohë. Për më tepër, iu referua nenit 20 të LSHMAAV, ku janë përcaktuar kompetencat e drejtorit, duke përfshirë të drejtën për të propozuar vendime që janë në kompetencë të Këshillit. Ai shtoi se është në komunikim të vazhdueshëm me Shërbimin Profesional për këtë çështje. Lidhur me Rregulloren e Punës së Agjencisë, ai citoi nenin 19, i cili konfirmon se seancat thirren nga Kryetari i Këshillit, që do të thotë se është e drejtë e tij të vendosë se cilat pika do të propozojë. Gjithashtu, ai theksoi se anëtarët që nuk do të jenë në gjendje të marrin pjesë në seancë obligohen ta njoftojnë kryetarin përmes postës elektronike ose telefon, që nuk është respektuar gjithmonë nga disa anëtarë. Për më tepër, ai iu referua nenit 22 të Rregullores së Punës, sipas të cilit Rendi i ditës për seancë definohet në fillim të tij, me propozim të Kryetarit të Këshillit. Njëkohësisht, secili anëtar ka të drejtë që në fillim të seancës të propozojë shtimin e një pike të re, prandaj tani do ta mbështesë propozimin e z.Trajçev.

Z. Fidanoski, në kontekst të diskutimit, shprehu mbështetje për të drejtën e z.Trajçev për propozim të pikës "Të ndryshme" ose një pike të emërtuar konkretisht në rendin e ditës. Ai theksoi se kjo është e drejtë procedurale e çdo anëtari të Këshillit, siç e theksoi më parë dhe Kryetari i Këshillit, kompetenca e të cilit është të hartojë rendin e ditës dhe në atë formë të propozohet për miratim në seancë. Z. Fidanoski kujtoi se ai vetë, në fillim të mandatit të tij, kishte propozuar një pikë konkrete të rendit të ditës, atëherë i është sugjeruar se për këtë pikë është e nevojshme paraprakisht të përgatitej material me shkrim, gjë që ai e pranoi si një procedurë e arsyeshme dhe e justifikuar. Lidhur me pikën "Të ndryshme", ai theksoi se Këshilli edhe më parë e ka pasur këtë praktikë. Megjithatë, ai shtoi se është e drejtë e Kryetarit të Këshillit të vendosë nëse do të propozohet si pikë e rendit të ditës. Si një kompromis i mundshëm, propozoi që nëse nuk parashihet pika "Të ndryshme" në rendin e ditës, çdo anëtar që duhet të deklarohet për çështje që lidhen me punën e Këshillit ose tema aktuale nga sfera mediatike, mund të propozojë pikë konkrete të rendit të ditës, pa njoftim paraprak të detyrueshëm të përmbajtjes. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që pas pikës së propozuar duhet të vijojë diskutim ose të miratohen konkluzat. Ai vuri në dukje se e mbështet z.Trajçev në shprehjen e mendimit të tij për çështje të caktuara në kuadër të kompetencave të Këshillit ose lidhur me sferën mediatike, nëse ky është qëllimi i tij.

Z. Trajçev theksoi se nuk po propozon një pikë "Të ndryshme" sepse ka nevojë konkrete për të deklaruar mbi një temë të caktuar në këtë seancë, por në parim ai propozon që kjo pikë të përfshihet si një praktikë e rregullt në çdo seancë. Lidhur me prezantimin e

z.Petrushevski, ai theksoi se me vëmendje i dëgjoi argumentet dhe dispozitat e numëruara të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe Rregullores së Punës, dhe konstatoi se këto dispozita nuk kanë pësuar asnjë ndryshim në dhjetë vitet e fundit. Ato ishin në fuqi dhe atëherë kur Këshilli praktikonte përfshirje të rregullt të pikës "Të ndryshme" në rendin e ditës, dhe bazuar në këto dispozita, shqyrtoheshin propozimet e paraqitura nga anëtarët. Ai shtoi se nuk e konteston të drejtën e z. Petrushevski, si Kryetar i Këshillit, për të përcaktuar rendin e ditës, dhe se kjo e drejtë garantohet me rregulloret në fuqi. Ajo që e habit, siç theksoi ai, është pse pas kaq shumë kohësh të një praktike të vendosur që u lejonte anëtarëve të diskutonin lirisht për çështje të caktuara, çështje që, siç përmendi dhe z.Fidanoski, nuk kërkojnë gjithmonë përgatitjen e materialeve nga Agjencia - papritmas kjo mundësi hiqet. Z.Trajçev theksoi se propozimi i tij nuk rrjedh nga një nevojë personale, sepse sipas kujtesës së tij, asnjëherë personalisht nuk e ka shfrytëzuar mundësinë për diskutim nën pikën "Të ndryshme", por se ai e mbështet këtë për arsye parimore. Ai theksoi se është e rëndësishme që anëtarët e Këshillit të kenë liri demokratike të shprehjes dhe të jenë në gjendje, në çdo seancë, të deklarohen hapur për çështjet që i konsiderojnë të rëndësishme. Ai përsëriti se të gjitha nenet dhe dispozitat ligjore që janë cituar deri më tani janë të pandryshuara dhe se pikërisht mbi bazën e tyre kryetari z. Petrushevski, dhe më parë kishte propozuar pikën "Të ndryshme", duke mundësuar kështu një shkëmbim të lirë dhe demokratik të qëndrimeve. Ai potencoi se tani, pa qenë ligjërish i diskutueshëm, kryetari i Këshillit ka zgjedhur ta përdorë të drejtën e tij në mënyrë që, sipas mendimit të tij, kufizon të drejtën e caktuar të anëtarëve, për shkak se është e paqartë pse pas kaq kohësh, kur kishte hapje për diskutim, po zbatohet një qasje e tillë.

Z. Petrushevski shprehu dyshime rreth qëllimeve të z.Trajçev, duke marrë parasysh përvojën e tij gjatë dhjetë viteve të fundit. Megjithatë, potencoi se do të mbështeste të drejtën e z. Trajçev, si anëtar i Këshillit, që propozimi për pikën "Të ndryshme" të përfshihet në rend të ditës. Z. Petrushevski shtoi se nuk e konsideron të nevojshme të shpjegojë publikisht pse mori qëndrimin dhe vendimin e lartpërmendur, pasi propozimi i rendit të ditës është kompetencë e tij ligjore si Kryetar i Këshillit të Agjencisë, që është konstatuar edhe me rregulloret përkatëse ligjore. Së fundmi, ai tregoi se z. Trajçev mund të kërkojë përkrahje nga anëtarët e Këshillit për zgjedhjen e një kryetari tjetër, i cili mund të vepron ndryshe.

Z. Trajçev tha se, megjithëse e kishte menduar nëse në të njëjtën masë do t'i përgjigjej asaj që tha z. Petrushevski, i cili nuk mund t'i dinte qëllimet e tij, për mirësjellje vendosi të përmbahej. Ai përsëriti se i gjithë diskutimi dhe propozimi për pikën "Të ndryshme" janë ekskluzivisht për arsye parimore, me qëllim që t'u mundësohet anëtarëve të Këshillit lirinë e shprehjes, e cila më parë kishte qenë praktikë e zakonshme. Z. Trajçev theksoi se me këtë e mbyll diskutimin e tij dhe nuk do të komentojë më tej, dhe pavarësisht faktit se ai beson se kjo nuk është hera e parë që është përballur me incidente të tilla personale, jo vetëm ndaj tij, por edhe ndaj anëtarëve të tjerë të Këshillit, dhe i kërkoi z. Petrushevski t'i mbante për vete mendimet dhe komentet e tij personale për anëtarët e tjerë të Këshillit.

Z. Petrushevski u pajtua se nuk është e nevojshme që diskutimi të vazhdonte në të njëjtin drejtim. Ai kujtoi se të gjithë e dinë shumë mirë se çfarë ka ndodhur në dhjetë vitet e fundit, si janë sjellë anëtarët e Këshillit, sa kanë kontribuar në punën e Agjencisë dhe kush çfarë ka punuar konkretisht.

Z. Fidanoski apeloj që të ruhet niveli dhe dinjiteti i punës në Këshill. Ai kujtoi se të gjithë anëtarët janë kolegë për më shumë se dhjetë vjet në këtë institucion dhe megjithëse ndonjëherë kanë pasur diskutime më intensive për çështje të caktuara, asnjëherë nuk janë

tejkualuar kufijtë e sulmeve "ad hominem" ose akuzave personale. Prandaj, ai bëri thirrje që të ruhet një qasje kulturore dhe profesionale në bisedimet e mëtejshme. Z.Fidanoski theksoi se është e drejtë e Kryetarit të Këshillit të propozojë rendin e ditës, por mendon se do të ishte e arsyeshme, në rast se pika "Të ndryshme" nuk është përfshirë në rend të ditës, që secili anëtar të ketë mundësinë ta propozojë këtë pikë në fillim të seancës, gjatë konstatimit të rendit të ditës.

Këshilli i Agjencisë, duke përfshirë Pikën 5 – Të ndryshme, njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale mbajtur më 08.05.2025.
2. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: printim me qira.
3. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: mirëmbajtje e ueb faqeve të Agjencisë.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës – nën pragjet e vlerës për lëndën e mëposhtëm - mallra: dollap metalik.
5. Të ndryshme

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 19-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 08.05.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef kabineti mr. Dragica Ljubevska, arsyetoj Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: printim me qira. Ajo shpjegoi se ky furnizim është parashikuar me Planin Financiar të Agjencisë, si dhe me Planin për furnizim publik për vitin 2025. Duke pasur parasysh se kontrata që rezulton nga ky furnizim do të lidhet për periudhë dyvjeçare, pjesa e mjeteve të mbetura do të sigurohen nga Plani Financiar për vitin 2026. Ajo theksoi se operatori ekonomik duhet të sigurojë skanim dhe printim pandërprerje të materialeve të punës për nevojat e organit kontraktues - Agjencisë, me cilësi të lartë dhe pa ndërprerje. Për ofertë më të favorshme do të zgjidhet ajo që ofron çmimin më të ulët. Për këto arsye, propozohet të jepet pajtueshmëri për zbatimin e procedurës për furnizim publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratim mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga drejtori i Agjencisë në pajtim me Autorizimin, ark.nr.03-1112/1 datë 19.03.2025, për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Printim me qira.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Printim me qira, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet janë të siguruara me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025, përkatësisht do të parashikohen shtesë në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 3

Udhëheqësja Ljubevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: mirëmbajtja e ueb faqeve të Agjencisë. Ajo shpjegoi se ky furnizim është i nevojshëm për shkak të nevojës për mirëmbajtje të vazhdueshme të ueb faqeve dhe mundësimin të funksionimit dhe mirëmbajtjes normale të serverit VDS. Ajo deklaroi se Agjencia ka katër ueb faqe: ueb faqen e përgjithshme të disponueshme në www.avmu.mk, si dhe faqet "Arsimimi mediatik", "Gjinia dhe mediat" dhe "Kodi zgjedhor online". Kontrata për furnizim publik do t'i ndahet sipas parimit të ofertës ekonomike më të favorshme, me kriter çmimit më të ulët. Mjetet për këtë furnizim janë siguruar me Planin Financiar, ndërsa furnizimi është parashikuar me Planin për furnizime publike për vitin aktual.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga drejtori i Agjencisë në pajtim me Autorizimin, ark.nr.03-1112/1 datë 19.03.2025, për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtja e ueb faqeve të Agjencisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: mirëmbajtja e ueb faqeve të Agjencisë, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet janë të siguruara me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Pika 4

Z. Petrusevski në lidhje me Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës - nën vlerën e pragjeve për lëndën e radhës - mallra: dollap metalik, shpjegoi se ky furnizim do të kryhet nëpërmjet negociatave të drejtpërdrejta ose duke zgjedhur midis disa ofertave si në këtë rast, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me furnizim të dollapi metalik. Ai propozoi që të kalohet në votim për këtë pikë, me qëllim që t'i jepet miratim drejtorit ose udhëheqësja Ljubevska, e cila po e zëvendëson drejtorin, të nënshkruajë kontratën me ofertuesin e zgjedhur që do të ofrojë çmimin më të ulët.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga drejtori i Agjencisë në pajtim me Autorizimin, ark.nr.03-1112/1 datë 19.03.2025, të marrë Vendim për miratimin e mjeteve financiare për furnizim të mallrave: Dollap metalik/dollap me konstrukcion metalik me 4 rafte, me sistem mbylljeje qendrore, me vlerë të parashikuar nën pragjet e vlerës me zbatim të Ligjit për furnizime publike, në shumën prej 18.958,00 denarë pa TVSH (22.370,00 denarë me TVSH).

Për realizimin e shërbimit të lartpërmendur mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**